



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 korrik 2014
Nr.ref.:RK680/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI45/14

Parashtrues

Faton Sefa

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2013,
të 13 nëntorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Faton Sefa, me vendbanim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 60/2013, të 13 nëntorit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 dhjetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), respektivisht neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), respektivisht neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe neni 1 (Mbrojtja e Pronës) i Protokollit 1.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën KI45/14 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 prill 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
7. Më 7 maj 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta dorëzojë autorizimin dhe të sigurojë disa sqarime lidhur me kërkesën, respektivisht, marrëdhënien me kërkesat e mëparshme KI75/12 dhe KI37/13. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 16 maj 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin, pa ofruar ndonjë sqarim shtesë.
9. Më 26 qershor 2014, gjyqtari Kadri Kryeziu e njoftoi Gjykatën me shkrim për përjashtimin e tij nga këshillimet për periudhën qershor – korrik 2014, derisa Gjykata të vendosë lidhur me pretendime të caktuara, të ngritura kundër tij.

10. Më 1 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. KSH. KI45/14, e zëvendësoi gjyqtarin Kadri Kryeziu me gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues.
11. Më 1 korrik 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Baza faktike e kërkesës KI45/14 është e njëjtë me atë të kërkesave KI75/12 dhe KI37/13, gjithashtu të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi i kërkesës.
13. Shumica e fakteve kanë të bëjnë me çështjen e ndërprerjes së kontratës së punës më 18 gusht 2006 në mes të ndërmarrjes "Hidrosistemi Radoniqi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Ndërmarrja) dhe parashtruesit të kërkesës.
14. Kjo çështje ishte objekt i shqyrtimit në procedura administrative dhe gjyqësore në gjykatat e rregullta, respektivisht deri më 2 maj 2012.
15. Më 2 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme konstatoi se *"[...] marrëdhënia e punësimit të paditësit është ndërprerë në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligjin në fuqi, andaj çdo pretendim në revizion mbi këtë bazë është i papranueshëm"*.
16. Sidoqoftë, në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën për përsëritje të procedurës së përfunduar me Aktgjykimin Ac. nr. 176/2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 9 shkurtit 2010.
17. Në ndërkohë, më 13 gusht 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI75/12, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili pretendohet t'i ketë injoruar shkeljet procedurale në komisionin disiplinor.
18. Më 13 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktvendimi KAC. nr. 6/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për përsëritje të procedurës në Gjykatën e Qarkut në Pejë, të përfunduar me Aktgjykimin Ac. nr. 176/2009 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 9 shkurtit 2010. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme.
19. Ndërkohë, më 15 janar 2013, Gjykata e deklaroi kërkesën KI75/12 të papranueshme, si qartazi të pabazuar (shih Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI75/12, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012).
20. Më 13 mars 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën KI37/13, duke kërkuar rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KI75/12, me pretendimin se Gjykata nuk i ka shqyrtuar dëshmitë shtesë, të dorëzuara prej tij.
21. Më 31 maj 2013, Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën KI37/13 të papranueshme, sepse Gjykata tashmë ka vendosur për rastin në kërkesën

KI75/12 (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI37/13, Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI75/12, të 15 janarit 2013).

22. Më 13 nëntor 2013, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 60/2013) e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, KAC. Nr. 6/2012, të 13 dhjetorit 2012. Gjykata Supreme konstatoi se *“gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se propozimi për përsëritjen e procedurës është i pabazuar nga se fakti gjegjësisht prova në të cilën paditësi e ka mbështetur propozimin për përsëritjen e procedurës, nuk paraqet provë të re në bazë të së cilës për palën mund të merrej vendim më i favorshëm po të ishte përdorur në procedurat e mëparshme”*.
23. Referenca në faktet e përshkruara më lart dhe vendimet e cituara janë marrë nga kërkesat e mëparshme, KI75/12 dhe KI37/13, pasi që sqarimet shtesë nuk ishin siguruar nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Si në kërkesat e mëparshme të dorëzuara në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e gjykatave të rregullta ishin marrë me shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, sepse edhe Gjykata e Qarkut në Pejë, e edhe Gjykata Supreme, pretendohet t'i kenë injoruar shkeljet procedurale në procedurën disiplinore.
25. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se shkëputja e kontratës së punës së tij ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai kurrë nuk kishte pasur takim me ndërmarrjen dhe me shkëputjen e marrëdhënies së punës nuk ishte saktësuar cilat dispozita ligjore ishin shkelur nga ai.
26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të shqyrtojë se me provat e ekzaminuara para gjykatës së shkallës së parë, ajo Gjykatë në mënyrë të drejte ka vepruar, ka aplikuar ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se procedurat para Gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë në atë fazë të procedurës të ketë pasur gjykim të drejtë, për kundër shkeljeve të parimeve të tilla nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës në Procedurën e revizionit”*.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

29. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur::

(...)

e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;

30. Gjykata vëren se shkëputja e kontratës është objekti i përbashkët i çështjes së tri kërkesave, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, edhe pse janë dy aktgjykime të Gjykatës Supreme, njëri për revizion (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) dhe tjetri për përsëritjen e procedurës (Aktvendimi Rev. nr. 60/2013).
31. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e ri në baza kushtetuese dhe nuk ka siguruar dëshmi shtesë se të drejtat dhe liritë themelore të tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta.
32. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme Aktvendimin e saj (Rev. nr. 60/2013), kur e kishte refuzuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, Gjykata nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse kishin qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, Vendim i GJEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
33. Gjykata më tej vëren se në kërkesën KI45/13, parashtruesi nuk ka bërë ndonjë referencë në kërkesat e dorëzuara më parë, përkatësisht kërkesat KI75/12 dhe KI37/13, që tashmë janë vendosur nga Gjykata. Një sjellje e tillë nuk është në pajtim me të drejtën e individit për peticion, sipas standardeve juridike evropiane (shih, *mutatis mutandis*, *Hadrabova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri nr. 42165/02 dhe nr. 466/03, të 25 shtatorit 2007).
34. Për më tepër, Gjykata përsërit se parashtruesi i kërkesës është i obliguar që ta njoftojë Gjykatën për të gjitha rrethanat relevante në lidhje me kërkesën dhe të mos mbajë ndonjë informatë që ka në dijeni. Përndryshe, ruajtja apo vënia e Gjykatës në lajthitje, mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për peticion.
35. Gjykata më tej vëren se lidhur me kërkesat KI75/12 dhe KI37/13, parashtruesi i kërkesës e kishte pasur rastin të njoftohej me procedurën e Gjykatës. Për më tepër, vendimet e Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesave të tij të mëparshme do të duhej ta kishte vetëdijesuar atë se kërkesa KI45/13 në thelb ka të bëjë me të njëjtin objekt të çështjes, tanimë të shqyrtuar nga Gjykata në kërkesat KI75/12 dhe KI37/13 dhe se nuk është paraqitur asnjë informatë e re dhe e rëndësishme.

36. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se një vendim lidhur me çështjen në fjalë tanimë është nxjerrë nga Gjykata dhe parashtruesi i kërkesës nuk ka siguruar bazë të mjaftueshme për një vendim të ri.
37. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (3) e të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI75/12, të 2 majit 2012, dhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI37/13, të 15 janarit 2013).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (3) e dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 1 korrik 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani